

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Krijuaam një zyrë turistike, por unë kam dëshirë të shumëfishoj rrugët turistike dhe hotelet e vogla, me që llim..." / Intervista e panjohur e Mbretit Zog, dhënë gazetës franceze, "Matin", 19 qershor 1935
ADRESA	https://www.gazetatema.net/dossier/krijuaam-nje-zyre-turistike-por-une-kam-deshire-te-shu-mefishoj-rruget-tur-i589060
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 05:40:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 05:35:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a1e2c6bbd39fa2762a0ca931720762f1de05bbad7b9bb0d654d445da162ed7ae
TEKSTI	5bb9d3d8eed38ce2cc7b37b6a2792d9d4db10763cb04dc67af72df2ebae6f91d
PAMJA	24ea6de9f0bf1a5ad0f39862e62d8d97cf92b7b55f815123a8b78b2dba514557

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	30e26d45665a2eb568fa74308cbe217dc6410d0dfe0e90aba3635aee71f669ab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5eafe312c168c8cb7947308588661084dd025e8060ada60f7d94b18122ee4218
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/30e26d45665a2eb568fa74308cbe217dc6410d0dfe0e90aba3635aee71f669ab

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie "Krijua nje zyre turistike, por une kam dëshirë te shumeshoj rrugët turistike dhe hotelet e vogla, me qëllim..." / Intervista e panjohur e Mbretit Zog, dhene gazetes fran fundit

“Krijua një zyrë turistike, por unë kam dëshirë të shumëfishoj rrugët turistike dhe hotelet e vogla, me qëllim...”/ Intervista e panjohur e Mbretit Zog, dhënë gazetës franceze, “Matin”, 19 qershor 1935



29 Shtator 2026, 07:35 Dossier TEMA



Gazeta franceze, “Le Matin”, ka botuar të mërkurën e 19 qershorit 1935, në faqe të parë dhe të dytë, intervistën e këshilltarit bashkiak të Parisit, Z. Alex Biscarre, me Mbretin Zog, në pallatin mbretëror me vendodhje në kryeqytetin shqiptar. Fillimisht, Z. Biscarre ka përshkruar figurën e Ahmet Zogut, i cili sigurisht nuk e ka lënë aspak indiferent. Madje, mund të konstatojmë edhe një lloj admirimi të tij për Mbretin e shqiptarëve. Në vijim, francezi ka rrëfyer procedurën e nevojitur për të takuar monarkun shqiptar, institucionet apo personat e nevojshëm që duheshin kontaktuar për të realizuar intervistën.

Ndërsa, në fund, gjejmë intervistën e tij të plotë me sovranin shqiptar, të sjellë asokohe për publikun francez dhe frankofon.

Çfarë përmban konkretisht kjo intervistë? Për më shumë, do të gjeni shkrimin e plotë, të sjellë në shqip nga Aurenc Bebja, Blogu “Dars (Klos), Mat – Albania”:

“Mbreti Zog ka tipare të një vazhdimësie të rregullt, një ballë të gjerë dhe një vështrim të sinqertë e të qartë, dhe të gjithë butësinë e vendeve të Lindjes. I gjatë dhe i hollë, pa vese, disi i ftohtë, Zogu I-rë, Mbret i shqiptarëve, më priti në pallatin e tij në Tiranë, i rrethuar nga lulishte trëndafilash. Ky djalë i vërtetë i Shqipërisë, fëmijë malësor, mbretëron, mbi të gjitha, falë punës së tij. Ai e ka bindur popullin e tij falë përkushtimit dhe sakrificës së tij.

Megjithëse, ditë e natë, zhurmat nga jashtë mbërrijnë deri në Pallat, Mbreti, i izoluar në një kabinet të gjerë pune, lexon, studion dhe sheh vetë të gjitha raportet (shkresat) e ministrave të tij. Metoda e tij është heshtja. Ai nuk bën shpallje të mëdhaja, gjepte teatrale apo deklarata këmbëngulëse. Mbreti nuk ka kontakt me asnjë person dhe jeton i rrethuar vetëm me motrat dhe nipin e tij, ndërsa dy nipërit e tjerë të tij ndjekin studimet në Saint-Cyr, në Francë.

Kohët e fundit, Oborri Mbretëror është në zi, si arsye e vdekjes së Nënës Mbretëreshë. Që të futesh në Pallat dhe të pritesh për audiencë, është thelbësore të mbështetesh në diplomacinë e ministrit tonë në Tiranë, Z. Marcel Ray, dhe me padyshim në kortezinë e Z. Rrok Stani, shef i protokollit. Duhet githashtu të kalosh në shtëpinë (akademine) ushtarake, nga ku Mbreti më shoqëroi bashkë me një punonjës të Oborrit.

Mbreti shtatëllartë iu përgjigj përshëndetjeve të mia rituale. Ai më zgjati dorën e tij të gjatë dhe të hollë për të më ofruar një cigare. Fjalët e tij të para, që më tha, ishin:

- Unë jam shumë i lumtur që një gazetë e madhe franceze dëshiron të interesohet për Shqipërinë. Ju do të jeni këtu për të gjykuar përpjekjet e një vendi të ri për t'u modernizuar.
- Unë kërkoj ndihmën dashamirëse të fqinjëve të mi sepse, nga pikëpamja e jashtme, politika ime është e thjeshtë. Ajo tenton të ruajë pavarësinë e Shqipërisë – përfundimisht pjesëmarrëse e koncertit evropian – dhe të mbajë kufijtë e mi të pandryshuar.
- Naltmadhëri, kufijtë tuaj mbrojnë një vend të mrekullueshëm të cilin unë do të përpiqem ta bëj të njohur në mesin e francezëve.
- Për këtë qëllim (u përgjigj sovrani) pashë me kënaqësi krijimin e një zyre turistike, por unë kam dëshirë të shumëfishoj rrugët turistike dhe hotelet e vogla, për t'i vënë dispozicion të vizitorëve. Sa më shumë të mësojnë për vendin tonë, aq më shumë do ta duan atë.
- Unë dua, për popullin tim, të vazhdoj të ndjek përpjekjet e mësuesve francezë të Liceut të Korçës. Arsimi francez do të mundësojë të mbajë gjallë ndjenjat miqësore të shqiptarëve që kur luftuan dhe u anagazhuan për Francën.
- Mbreti e ka fjalën për krijimin e lëvizjes së parë për pavarësi – e paraprirë nga rekrutime vullnetare – nga trupat e Sarraill-it në vitin 1917 në qytetin e Korçës.
- Unë kam inkurajuar krijimin e linjave ajrore dhe mund, për disa orë, të shkojmë nga Tirana në Romë dhe nga Roma në Paris.

Pastaj sovrani më pyeti për qytetet që kisha vizituar dhe ishte i kënaqur për interesin që ato ngjallnin. Ai është përpjekur ti lidhë (bashkojë) të gjitha me anë të rrugëve, dhe në përfundim, më fton që të kthehem sërish, pas dy ose tre vitesh, për të parë progreset e mëtejshme. / Memorie.al

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Studimi: Si e ndihmoi Stasi ekonominë e Gjermanisë Lindore përmes vjedhjes së teknologjisë perëndimore

22:50 Dossier / 1 koment

"Mund të pritet ndoshta një sulm ushtarak nga jugosllavët, po edhe nga grekët, duke thënë: 'Do të hyjmë të mbrojmë vëllezërit tanë në minoritet', prandaj Ushtria..." / Fjala e Ramiz Alisë në Plenum, 6 korrik '90

08:13 Dossier / 5 komente

Vetëvrasje apo vrasje? Dokumente të reja rihapin misterin e mbesës së Hitlerit

22:20 Dossier / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.